



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"

Prizren  
SENATI

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pandar me sh.	
Zyra e përinimit	Nr. i protokolit
308	01-112

37.04.2020

Rruja e Shkronjave Nr. I, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage:  
[www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Nr. i ref.:

Prizren, më: 21.4.2020

Mbështetur në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Senati i Universiteti, për shkak të Pandemisë Covid-19 dhe vendimieve të institucioneve qendore, në mbledhjen e realizuar online përmes deklarimit me email, merr këtë:

**V E N D I M**  
për funksionalizimin e Sistemit kundër plagjiaturës në Universitet.

- I. Sistemi antiplagjiat do të fillojë të zbatohet prej datës 1 Maj 2020 përmes Sistemit të SMU-së;
- II. Shërbimet të cilat do të kryhen përmes sistemit të kontrollit të antiplagjiaturave do të jenë: punimet e diplomës BSC dhe MSC, punimet seminarike, punimet e profesorëve, etj.
- III. Punimet Seminarike, dhe Punimet e Diplomës BSC dhe MSC mund t'i kontrollojnë studentët dhe profesorët;
- IV. Me vendim të veqantë, këto punime mund t'i kontrolloj edhe një Komision prej tre anetarësh i formuar nga Rektori, kur konsiderohet e nevojshme ne rast të ndonjë ankesë ose dyshimi të bazuar për keqpërdorim. Komisioni do të përpilojë procesverbal me rastin e kontrollit;
- V. Sistemi i instaluar, do të bëjë kontrollimin e punimeve në dy mënyra:

Mënyra online: ku do të kërkohet në shfletuesit dhe makinat kërkimore, për punime të ngjashme dhe do ta identifikoj secilën pjesë nëse është kopjuar apo tentohet të bëhet plagjiaturë. Sistemi do të saktësoj secilën pjesë të punimit se ku është kopjuar apo nga është marrë dhe atë do ta paraqesë me përqindje.

Kontrolli i punimeve seminarike, punimit të diplomës, punimeve shkencore ndërmjet Universitetit brenda sistemit. Mënyra e kontrollit në bazë të të dhënave, ku punimet e studentëve, profesorëve, do të kontrollohen edhe me punimet paraprake të cilat janë dorëzuar dhe verifikuar në sistem, nga data: 1 Maj 2020.

- VI. Ngjashmëria e punimit mbi 20% për Studimet Master dhe 30% për Studimet BSC, me ndonjë punim tjetër konsiderohet plagiati.

- VII. Studentet dhe profesoret janë te obliguar që të përdorin konfirmimin e sistemit para procedimit të mëtujeshëm;
- VIII. Obligohet Zyra e IT-së dhe operatori ekonomik, të ju krijoj qasje profesoreve dhe Studentëve në sistemin e SMU-së.
- IX. Operatori ekonomik të dorëzojë një udhëzues për përdorimin e sistemit;
- X. Vendimi hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit, ndërsa sistemi do të fillojë të zbatohet, prej datës: 1 maj 2020.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Anëtarëve të Menaxhmentit;
2. Njësive akademike;
3. Sekretarit të Përgjithshëm;
4. IT, web dhe SMU;
5. Arkivit.

Kryesues i Senatit,

Prof. Asoc. Dr. Jemal Toma

